



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:205582

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05882255

KPPP.nr.1545/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përbarimore të kreditorit “Inovix” SH.P.K., me numër unik identifikues 810137051 me seli në Prishtinë rr. “Ilaz Kodra”, kundër debitorit “Trepça” SH.A., me numër unik identifikues 811278747 me seli në Mitrovicë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.1636/23 të datës 29.08.2023 të Përbaruesit Privat Valdrin Beka, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datës 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Trepça” SH.A., ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr.1636/23 të datës 29.08.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Valdrin Beka, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Inovix” SH.P.K., ka lëshuar Urdhrit Përbarimor P.nr.1636/23 të datës 29.08.2023 me të cilin e ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm, Faturës me nr.23/22 të datës 24.05.2022 me të cilin ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 5,211.00€ me kamatë ligjore prej 8% deri në pagesën e plotë si dhe shpenzimet e procedurës së përbarimit përmes bllokimit të të gjitha llogarive bankare dhe regjistrohet, konfiskohet dhe shitet pasuria e debitorit si në sende të luajtshme po ashtu edhe paluajtshmëri të tjera në tërë masën pasurore të debitorit.

Debitori, ndaj urdhrit mbi lejimin e përbarimit ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar urdhrin përbarimor, me arsyetimin se dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përbarues, nuk e përmban origjinalin apo kopjen e vërtetuar të

dokumentit të besueshëm. Debitori thekson se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim nuk i plotëson kushtet që dalin nga neni 29 dhe neni 37 të LPP-së, për të qenë dokument i besueshëm, pasi që nuk është dokument origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit. Andaj, gjykatës i ka propozuar që të aprovoj prapësimin e debitorit në tërësi si të bazuar dhe të anuloj urdhrin përmbartimor të Përmbartuesit Privat Valdrin Beka, me numër, P.nr.1636/23 të datës 29.08.2023.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se Urdhri Përmbartimor P.nr.1636/23 të datës 29.08.2023 bazohet në dokumentin e besueshëm, Faturën me nr.23/22 të datës 24.05.2022, në shumën prej 5,211.00€, mirëpo e njëjta nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm për faktin se fatura në rastin konkret përveç emrit, nuk përmban asnjë të dhënë tjetër të debitorit si numri unik identifikues dhe selinë e debitorit. Andaj duke qenë se fatura nuk përmban të gjitha të dhënat që mundësojnë identifikimin e saktë të debitorit në përputhje me nenin 29 par. 3 të LPP-së, gjykata vlerësoi se kjo faturë nuk mund të shërben si dokument i besueshëm në këtë rast.

Andaj, meqenëse dokumenti në bazë të së cilit është iniciuar kjo procedurë përmbartimore nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i përshtatshëm për përmbartim, në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1545/23, datë 28.06.2024.

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimet të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.